



Data: 29 Janar 2021

Për: Institucionet Financiare të Republikës së Kosovës

Nga : Administrata Tatimore e Kosovës

Tema: Kutia TIN nga të dhënat FATCA

Njoftim,

Në përpjekjet e IRS për të kuptuar më mirë çështjet me të cilat Institucionet e Huaja Financiare përballen në marrjen e TIN-it të SHBA-së, IRS ka zhvilluar një seri kodesh që mund të përdoren nga këto institucione raportues të Modelit 1 për të populluar kutinë e TIN.

Përdorimi i këtyre kodeve nuk është i detyrueshëm dhe nuk do të thotë që një Institucion i Huaj Financiar nuk do të jetë në rrezik për tu konsideruar seriozisht si në mos-përmbushës për shkak të dështimit të raportimit të çdo TIN-i të kërkuar të SHBA-së. IRS do të marrë parasysh faktet dhe rrethanat që çojnë në mungesën e TIN-it të SHBA-së, të tilla si arsytet pse TIN-i nuk ka mundur të merrej, ose nëse Institucioni i Huaj Financiar ka procedurë të përshtatshme për të marrë TIN-ët dhe përpjekjet e bëra nga Institucionet e Huaja Financiare për të marrë TIN-ët. *Për shembull: a është Institucioni i Huaj Financiar duke i kontaktuar, apo jo, mbajtësit e llogarive për çdo vit, për të kërkuar TIN që mungon?*

Pritshmëritë janë që me anë të përdorimit të këtyre kodeve, ATK do të ketë mundësi të njohë më mirë faktet dhe rrethanat që qëndrojnë pas TIN-ve të SHBA-së që mungojnë, si në përgjithësi, ashtu edhe sa i përket ndonjë Institucionit të Huaj Financiar, specifik raportues i Modelit 1.

Kodi i fushës TIN dhe skenarët që lidhen me to janë si në vijim:

- 🚩 22222222 – Llogaria para ekzistuese individuale me vetëm një tregues identifikimi që është vendlindja në SHBA.
- 🚩 33333333 – Llogaritë e reja individuale që (1) kanë tregues të vendlindjes në SHBA, dhe (2) ose:



- (a) kanë ndryshim në rrethana duke bërë që vetë certifikimi i marrë fillimisht gjatë hapjes së llogarisë të jetë i pasaktë ose jo i besueshëm, dhe nuk është bërë një vetë certifikim i ri, ose
 - (b) ishin nën pragun e dokumentimit dhe raportimit të llogarisë në kohën e hapjes së llogarisë dhe më pas e kanë tejkaluar pragun, por nuk është bërë një vetë certifikim i ri.
- 444444444 – Llogaritë para ekzistuese individuale dhe të entitetit që (1) kanë tregues në lidhje me SHBA të ndryshëm nga treguesi i vendlindjes, dhe (2) ose:
- (a) kanë ndryshim në rrethana duke bërë që vetë certifikimi i marrë fillimisht gjatë hapjes së llogarisë të jetë i pasaktë ose jo i besueshëm, dhe nuk është bërë një vetë certifikim i ri, ose
 - (b) ishin nën prag të dokumentimit dhe raportimit të llogarisë në kohën e hapjes së llogarisë dhe më pas e kanë tejkaluar pragun, por nuk është bërë një vetë certifikim i ri.
- 555555555 –Llogaritë e reja individuale dhe të entitetit që kanë tregues në lidhje me SHBA të ndryshëm nga treguesi i vendlindjes, dhe (2) ose:
- (a) kanë ndryshim në rrethana duke bërë që vetë certifikimi i marrë fillimisht gjatë hapjes së llogarisë të jetë i pasaktë ose jo i besueshëm, dhe nuk është bërë një vetë certifikim i ri, ose
 - (b) ishin nën prag të dokumentimit dhe raportimit të llogarisë në kohën e hapjes së llogarisë dhe më pas e kanë tejkaluar pragun, por nuk është bërë një vetë certifikim i ri.
- 666666666 –Llogaria para ekzistuese e entitetit me bilanc të llogarisë që tejkalon \$ 1,000,000, që është mbajtur nga një Entitet i Huaj Jo Financiar pasiv në lidhje me të cilën nuk janë marrë vetë certifikime, dhe nuk është identifikuar asnjë tregues i SHBA sa i përket personave kontrollues.

Përveç kësaj, ju inkurajojmë që edhe ju si Institucione Financiare Raportuese t'i identifikoni problemet dhe të na paraqitni vështirësitë në marrjen e TIN.

Me respekt.